

Pasqyrat financiare te vitit 2019

OES DESTRIMED SH.P.K.

NIPT K31520054N

5. SHENIMET SHPJEGUESE

1. Informacione te pergjitheshme.

Shoqeria "OES Destrimed" eshte themeluar si SHPK, me NIPT: K31520054N e cila e ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare", I ndryshuar dhe Statutin e shoqerise.

Kapitali I regjistruar I shoqerise eshte aktualisht 423.000.000 leke.

Administrator te shoqerise jane: Ermal Rizaj dhe Orjadin Jaho.

Veprimtaria kryesore e shoqerise eshte :

Import-eksport, tregtim te pajisjeve dhe materialeve me perdorim mjekesor, laboratorik, parafamaceutik, farmaceutik, implante mjekesore aktive dhe jo aktive, kite reagente dhe materiale konsumi mjekesor aktive dhe jo aktive, kite reagente dhe materiale konsumi mjekesor dhe laboratorik, pajisje laboratorike, analitike, diagnostike e kerkimore, pajisje spitalore, mjekesore, elektronmjekesore, fizioterapike, elektronike, te ndryshme, pajisje dhe kabinete dentare si dhe materiale konsumi dentur, ,shitja e tyre me shumice dhe pakice, instalimi, sherbimi, mirembajtja dhe servisi i tyre, ETJ.

2. Deklerata e pajtuesmerise me SKK-te

Pasqyrat financiare(individuale) per qellime te perhjilleshme jane pergatitur dhe paraqiten ne perputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit(SKK) te permiresuara dhe me kerkesat e Ligjit ""Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"".

3. Bazat e pergatitjes se pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare jane pergatitur mbi bazen e parimit te koston historike, por duke e kombinuar me elemente te metodave te tjera dhe parimit te drejtave te konstatuara.

Pasqyrat financiare jane paraqitur ne monedhen Lekë.

3. Politikat kontabile te zbatuara

Mjetet monetare

Mjetet monetare perfshijne mjetet monetare ne arke dhe ne llogarite bankare, llogarite rrjedhese, si dhe, investime ne tregun e parase dhe tregje te tjera shume likuide me kontrata jo me te gjata se 3 muaj, te cilat jane objekti I nje rreziku jo dometheses te ndryshimeve ne vlere.

Fluksat monetare jane hyrjet dhe daljet e parase dhe ekuivalentet e tyre.

Veprimtarite e shfrytezimit jane aktivitetet baze te veprimtarise, te krijimit te te ardhurave te shoqerise si edhe aktivitetet e tjera, te cilat nuk jane veprimtari investuese dhe veprimtari e financimit.

Veprimtari investuese eshte blerja dhe nxjerrja e aktiveve afatgjata dhe investime te tjera qe nuk perfshihen ne ekujivalentet e mjeteve monetare.

Aktivitetet financuese jan aktivitetet qe cojne ne ndryshime ne masen dhe perberjen e kapitalit neto te kontribuar dhe te huase se shoqerise.

Aktivet dhe detyrimet financiare

Nje aktiv financiar ose nje detyrim financiar njihet vetem kur shoqeria behet pjese e kushteve kontraktuale te instrumentit, Matja fillestare e nje aktivi financiar ose e nje detyrimi financiar behet me koston e transakcionit (duke perfshire edhe cmimin e transakcionit), pervec rasteve kur marreveshja perben ne thelb nje transakcion financiar.

Nje transakcion financiar mund te jete, por shembull, kur shiten mallra apo sherbime dhe kur pagesa shtyhet pertej afateve normale te tregtise ose kur ajo eshte financuar me nje norme interesi qe nuk eshte nje norme tregu. Nese marreveshja perben nje transakcion financiar matja e aktivitet financiar ose e detyrimit financiar behet me vleren aktuale te pagesave te ardheshme te skontuara me normen

e interesit te tregut per nje instrument te ngjashem borxhi.

Ne fund te periudhes raportuese matja e instrumentave financiare behet si vijon :

Instrumental e borxhit te percaktuara ne piken 7 dhe 8 te SKK - 3 (si llogari deftese ose hua e arketueshme ose e pagueshme) matet me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv. Instrumentat e borxhit qe jane te klasifikuara si aktive aftshkurter ose detyrime afatshkurter maten me shumen e paskontuar te mjeteve monetare ose shumave te tjera te priteshme per tu paguar ose arketuar, pervec kur marreveshja perben, ne efekt, nje transakcion financiar. Nese marreveshja perben nje transakcion financiar matja e instrumentit te borxhit behet me vleren aktuale te pagesave te ardheshme te skontuara me nje norme tregu interesi per nje instrument te ngjashem borxhi.

Ne fund te cdo periudhe raportimi shoqeria vlereson nese ka nje evidence objektive te zhvleresimit te ndonje aktivi financiar qe matet me kosto ose me kosto te amortizuar.

Nese ka nje evidence objektive te zhvleresimit njohen menjehere shumat per humbje nga zhvleresimi ne fitim ose humbje. Nese ne nje periudhe pasuese, shumat e humbjes ose zhvleresimi zvogelohet dhe zvogelimi mund te lidhet objektivist me nje ngjarje qe ka ndoshur pasi ishte njohur zhvleresimi (si nje permiresim ne vleresimin e pozicionit financiar te debitorit) rimeret humbja nga zhvleresimi te njohur me pare ose direkt ose duke regulluar nje llogari zhvleresimi, ne fitim ose humbje. Aktivet dhe detyrimet financiare shoqeria I klasifikon ne afatshkurtra dhe afatgjata bazuar ne percaktimet e SKK-2.

Inventaret

Fillimisht inventaret njohen atehere kur shoqeria I ka nen kontroll, pret peefitime ekonomike prej tij, dhe kostoja e tij mund te vleresohet me besueshmeri.

Njohja e inventareve behet zakonisht ne momentin e perfitimit. Ai mate fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit perfshin : koston e te gjitha materialeve te lidhura drejtperdrejt me prodhimin si edhe koston e shnderrimit te ketyre materialeve ne produkte perfundimtare. Kostot e drejtperdrejte te materialeve perfshijne , pervec cmimit te blerjes edhe te gjitha koston e tjera qe nevojiten per te sjelle inventarin ne vend ndoshjen dhe gjendjen ekzistuese.

Kostoja e lendeve te para, materialeve te konsumit, tokes dhe ndertesave te blera per rishitje perbehet nga cmimi I blerjes , shpenzimet e transporti,, taksat e impritit, magazinimi, zbritjet dhe shtesat tregatire dhe shpenzime te tjera te ngjashme (taksat e parimbursueshme).

Pas njohjes inventari matet me vleren me te ulet midis koston dhe cmimit te vleresuar te sahitjes paksuar me koston per tu perfunduar dhe shitur.

Inventaret I neshitohet testit te zhvleresimit ne daten e raportimit.

Shpenzimet e shtyra dhe te arketueshme nga te ardhurat e konstatuara.

Shoqeria zbaton politikat e shtyrjes se shpenzimeve, te cilat do te sigurojne te ardhura ne periudhat e mevoneshme. Po ashtu ajo shperndan shpenzimet e parapaguara ne varesi te perdimit dhe sigurimit te te ardhurave.

Aktivete afatgjata materiale

Aktivete afatgjata materiale (AAM) njohen si nje aktiv vetem nese ai kontrollohet nga shoqeria, eshte e mundur per perfitime ekonomike te ardheshme nga perdorimi I aktivitet te hyrte dhe kostoja e aktivitet mund te matet me besueshmeri.Regjistrimi fillestar I AAM behet zakonisht ne momentin e perfitimit te tij nga blerja ose prodhimi.

Nje element I AAM qe ploteson kriteret per njohjen si aktiv ne pasqyren e pozicionit financiar matet me kosto. Ne vleresimin e me passhem shoqeria zbaton si politike te saj kontabel modelin e koston dhe e aplikon kete model per te gjitha klasen e AAM qe vleresohet.

Ne pasqyren e pozicionit financiar nje element I AAM-se paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Kosto qe kane te bejne me permiresimet e me passhme I shtohen koston se AAM-se vetem ne se

ato perbushin kriteret e perkufizimit te AAM-ve dhe kriteret per njohjen e aktiveve ne pasqyren e pozicionit financiar. Kosto qe lidhen me mirembajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si

shpenzime gjate vitit ushtrimor.

Shoqeria vlereson ne cdo date te raportimit nese ka ndonje shenje qe nje aktiv mun te jete I zhvleresuar.

Nese ekziston ndonje shemnje e tille, ajo vlereson shumen e rikuperueshme te aktivitetit.

Nese nuk ka shenja per zhvlersim, nuk eshte e nevojshme te vleresot shumta e rikuperueshme.

Vlera e amortizueshme e AAM-venjitet ne pasqyren e te ardhurave si shpenzim ne menyre sistematike pergjat jetes se dobishme te ketij aktivi. Perjashtime bejne AAM me jete te dobishme pa afat si per shembull toka (pervec minierave dhe vendeve te perdorura per groposje), punimet e artit me jete afatgjate, veprat e muzeve dhe librave , te cilat nuk amortizohen .

Amortizimi per te gjitha grupet llogaritet dhe njihet me metoden e vleres se mbeturme norma te cilat jane te peraferta me jetegjatesine mesatare te parashikuara te perdorimit.

Toka dhe aktivet ne proces nuk amortizohen. Notmat e perdorura jane ne ndertesa 5 % te vleres se mbetur dhe per aktivet e tjehra 20 % e vleres se mbetur.

Aktivet afatgjate jomateriale

Nje aktiv afatgjate jo material (AAJM) njihet vetem nese : eshte e mundur qe te kete perfitime te ardheshme ekonomike, kostoja e aktivitetit mund te matet me besueshmeri dhe aktivi nuk eshte rezultat I shpenzimeve te bera brenda shoqerise per nje ze jo material. Njohja fillestare e nje aktivi jo material behet me kosto , ndersa vleresimi I me passhem paraqitet me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akuluar nga zhvleresimi.

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Te ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit te te drejtave te konstatura. Matja e te ardhurave behet me vleren e drejte te arketuar ose te arkertueshme. Vlera e drejte e shumes se arketuar apo per tu arketuara merr parasysht shumen e cfaredo zbritjeje tregtar, zbritje per shlyerje te menjehershme dhe zbritjet e bera per sasi (vellim) te blere.

Te ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur jane plotesuar te gjitha kushtet e me poshteme : I jane kaluar bleserit te gjitha rreziquet dhe perfitimet, qe lidhen me pronesine e mallrave dhe produkteve ; shoqeria nuk vazhdon te jete e perfshire ne menyre te vazhdueshme ne manaxhimin e mallrave dhe produkteve ne ate mase qe tregon se ende zoteron titullin e pronesis se dhe /ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura; shumta e te ardhurave mund te matet me besueshmeri, eshte e mundur qe perfitimet ekonomike qe lidhen me transakcionin do te merren, koston qe kane ndodhur ose qe do te ndodhin ne lidhje me transakcionin, mund te maten me besueshmeri.

Te ardhurat qe rrjedhin nga perdorimi nga pale te treta I aktiveve te saj qe sjellin interes, perfitim pagesash per perdorime te prones (rojelliti) dhe dividende njihen si me poshte : te ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e metodes lineare ose te metodes se bazuar ne normen e brendsdhime te interesit efektiv; te ardhurat nga shfrytezimi I pronesitronjelliti) njihen mbi bazen e te drejtave dhe detyrimeve te konstatura ne perputhje me kushtet e kontrates, te ardhurat nga dividendet njihen kur aksioneri ka te drejte ligjore per te arketuar dividendin .

Shpenzimet njihen ne pasqyren e te ardhurave shpenzime atehere kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqeria pret te dalin aktive per shlyerjen e tyre ne te ardhmen.

Shoqeria zbaton parimin e krahasimit te te Ardhurave me shpenzimet brenda te njenjtit ushtrim kontabel. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen te ardhura prej tyre, pavaresisht nese jane fatuar apo paguar.

Transaksionet ne monedha te huaja

Transaksionet ne monedhe te huaj, qe plotesojne kushtet ne njohje, regjistrohet ne monedhe funksionale, duke zbatuar mbi shumen e monedhes se huaj kursin e menjehershem te kembimit (spot) ndermjet monedhes funksionale dhe monedhes se huaj ne daten e transakcionit, por shpesh perdoret nje kurs kembimi, i cili eshte i perafert me kursin e dates se kryerjes se transakcionit, psh nje kurs mesatrr i nje jave ose nje muaj mund te perdoret per te gjitha transakcionet e kryera gjate kesaj

periudhe, ne secilen prej monedhave te perdorura.

Ne fund te cdo periudhe raportuese, zerat ne monedhe te huaj perkthehen si me poshte :
zerat monetare te shprehur ne monedhe te huaj duke perdorur kursin e kembimit te mbylljes (dmth ne daten raportuese) ; zerat jo monetare qe maten me koso historike ne monedhe te huaj duke perdorur kursin e kembimit ne daten e transaksionit, zerat monetare qe maten me vleren e drejte ne monedhe te huaj duke perdorur kursin e kembimit ne daten kur eshte percaktuar vlera e drejte.

Diferencat e kembimit qe krijohen gjate shlyerjes se zerave monetare ose gjate perkthimit te zerave monetare me kurse kembimi te ndryshme nga kurset e kembimit, me te cilat ato jane perkthyer ne njohjen gjate periudhes kontabile aktuale, ose ne pasqyrat financiare te m.eparshme, njihen si fitim ose (humbje) te periudhes kontabile kur ato lindin.

Kur nje perfitim ose humbje per nje ze jo monetarnjihet drejtperdrejt ne kapital, atehere drejtperdrejt ne kapital do te njihet edhe diferenca e kembimit.

Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin perfshin tatimin e periudhes aktuale dhe tatimin e shtyre. Tatimi mbi fitimin njihet si shpenzim tatimor ne pasqyren e performances, pervec tatimit te zerave qe njihen direkt ne kapital, I cili njihet si nje ze I kapitalit.

Detyrimi tatimor aktual njihet ne vlerat qe shoqeria pritet te paguaj(rimbursoje) mbi bazen e normave tatimore dhe ligjeve tatimore qe jane miratuuar ose jane ne thelb te miratuara ne daten e raportimit.

Aktivi ose detyrimi tatimor te shtyre njihet per tatimet e zbriteshme (rimbursueshme) ose te pagueshme ne periudhat e ardheshme si rezultat I transaksioneve ose ngjarjeve te kaluara.

Keto tatime lindin nga ndryshimet mes vlerave te njohura per aktivet dhe detyrimet ne pasqyren e pozicionit financiar dhe njohjes se ketyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore, si dhe nga mbarnja e humbjeve tatimore dhe e tatimit te zbritshem (rimbursueshem) te pa perdorur.

Norma aktuale tatimit mbi fitimit per virth 2019 eshte 15% aq sa ka qene edhe ne ushtrimin para ardhes.

Mjetet monetare (likujditetet ne arke, banke, etj.)

Gjendjet e mjeteve monetare ne banke e arke, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit jane si me poshte:

Mjete monetare	399,419,584	Leke
----------------	-------------	------

Gjendja e llogarive te likujditeteteve te paraqitura ne pasqyrat financiare konfirmohen me ushtrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave ne fund te ushtrimit.

Tepriat e shprehura ne monedhe te huaj jane perkthyer ne leke duke perdorur kursin e kembimit te shpallur nga banka e shqiperise.

Te drejtat e arketueshme

Te drejta e arketueshme ne fund te periudhes kontabel deklarohen si me poshte:

<i>Të drejta të arketueshme</i>	<i>Leke</i>	<i>80,368,338</i>
1 <i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>		
2 <i>Nga njësitë ekonomike brenda grupit</i>		
3 <i>Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>		
4 <i>Të tjera</i>		
5 <i>Parapagime per inventar</i>	<i>Leke</i>	<i>8,765,881</i>

Shoqeria me 31.12.2019 paraqitet me parapagime te dhena per blerje mallra.

Inventari

Inventaret me 31.12.2019 eshte	<i>Leke</i>	<i>85,671,150</i>
--------------------------------	-------------	-------------------

Aktivet Afatgjata Materiale (AAM)

Aktivet afatgjata materiale ne daten e bilancit paraqesin vleren e plote te AAM qe ka shoqeria per ushtrimin e veprimtarise.

Ne pasqyren me poshte jane pasqyruar AAM me vleren e mbetur.

Toka dhe nderesa	Leke	144,884,923
Impiante dhe makineri	Leke	5,540,206
Te tjera instalime dhe pajisje	Leke	1,683,880
Totali		152,109,009

AAM -t qe plotesojne kriteret per njohje si aktiv ne pasqyren e pozicionit financiar jane matur me kosto.

Ne vleresimin e me passhem shoqeria zbaton si politike te saj kontabel modelin e koston dhe ne pasqyren e pozicionit financiar AAM -t jane paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi nese ka.

Vlerat dhe kalsifikimi ne grupe I AAM-ve te pasqyra ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit Dhjetor 2019.

Metoda e zgjedhur e amortizimit eshte metoda mbi vleren e mbetur e njenjte me ate qe perdoret per qellime fiskale.

Shoqeria vlereson ne cdo date te raportimit nese ka ndonje shenje qe nje aktiv mund te jete I zhvleresuar.

Drejtimi mendon se pergjithesisht ne kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te rënies ne vleren e AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.

Detyrimet afatshkurtra

Detyrimet afatshkurtra ne fund te periudhes kontabel jane sa me poshte :

1	<i>Titujt e huamartjes</i>		
2	<i>Detyrime ndaj institucioneve të kreditë</i>		
3	<i>Arkëtime në avancë për porosi</i>		
4	<i>Te pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>	Leke	10,991,657
5	<i>Dëftesa të pagueshme</i>		
6	<i>Te pagueshme ndaj njësitve ekonomike brenda grupit</i>		
7	<i>Te pagueshme ndaj punonjësve</i>		
8	<i>Te pagueshme ndaj punonjësve per sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>		578,706
9	<i>Te pagueshme për detyrimet tatimore</i>	Leke	14,063,684
10	<i>Te tjera te pagueshme: Dividende per tu paguar</i>	Leke	7,075,850
	Totali i Detyrimeve afatshkurtera	Leke	32,709,897

Detyrimet afatgjata

Detyrimet afatgjata shoqeria nuk ka.

Kapitali dhe rezervat

Kapitali I shoqerise I paraqitur ne pasqyren e pozicionit financiar eshte I njenjte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise dhe ate te regjistruar ne QKB ne daten e bilancit.

1	<i>Kapitali dhe Rezervat</i>		
2	<i>Kapitali i Nënshkruar</i>		
3	<i>Primi i lidhur me kapitalin</i>	Leke	423,000,000
4	<i>Rezerva rivlerësimi</i>		
5	<i>Rezerva të tjera</i>	Leke	9,282,608
6	<i>Fitimi i pashpërndarë</i>		108,654,949
7	<i>Fitim i Humbja e Vitit</i>	Leke	152,686,508
	Totali I kapitalit	Leke	693,624,065

Te ardhurat dhe shpenzimet e vitit ushtrimor 2019

Në te ardhura është paraqitur gjithë te ardhurat e realizuar nga veprimtaria e zakonshme e shoqërisë.

1	Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit	leke.	742,444,654
2	Te ardhura nga ndryshimi në inventarin e mallrave dhe prodhimit në proces	leke.	9,024,572
	Totali		751,469,226

Kosto e lendeve të para e të materialeve të tjera të njohura si shpenzim është :

Lenda e parë dhe materiale të konsumueshme	leke.	432,413,419
--	-------	-------------

Shpenzimet për personelin

Shpenzimet e personelit përbehen nga pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetsore, pjesëmarrja në fitime dhe shpërblimet. Shpenzimet vjetore të kryera për personelin dhe numri mesatar i punonjësve është si më poshtë :

1	Paga dhe shpërblime	leke.	19,668,386
2	Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas)	leke.	3,284,620
3	Totali për personelin	leke.	22,953,006
4	Numri mesatar i punonjësve	punonjës/muaj	16.8

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit

Në shpenzimet e tjera të shfrytëzimit janë përfshirë kosto e shërbimeve kryesore dhe ndihmese, që lidhen drejtpërdrejt me veprimtaritë e shfrytëzimit dhe ato për qëllime administrative, si edhe, kostot që ndodhin jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të biznesit.

keto shpenzime për vitin 2019 paraqiten në shumën e mëposhteme:

Shpenzime të tjera shfrytëzimi	leke.	86,016,857
--------------------------------	-------	------------

Amortizimi dhe zhvlerësimet

Amortizimi është llogaritur në përputhje me normat ligjore për të gjithë AAM-t

Shpenzime konsumi dhe amortizimi	leke.	9,471,155
----------------------------------	-------	-----------

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Në llogaritjen e shpenzimit të tatimit mbi fitimin janë respektuar kërkesat e legjislacionit fiskal, norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15 %

Rezultati kontabel	179,649,582	leke.
Shpenz. Pazbritshme	104,248	leke.
Rezultati tatimor	179,753,830	leke.
Tatim fitimi	26,963,075	leke.

Ngjarjet pas dates së bilancit dhe vijimsia

Drejtimi i shoqërisë është i vetëdijshëm se për gatitja e Paqyrave Financiare është përgjegjës i Drejtimit dhe është përpjekur që ato nuk përmbajnë gabime materiale

Drejtimi i shoqërisë ka ndjekur ngjarjet pas hartimit të Paqyrave Financiare dhe deri tani nuk ka asnjë të tillë që të ndikojë në rezultatin e ushtrimit të vitit 2019.

HARTUESI
SHOQERIA E KONTABILITETIT
"KONTABEL CENTER" SHPK
ADMINISTRATORI
Agim Heshi

KONTABEL CENTER
ELBASAN
L42605201N

DREJTUESI
ADMINISTRATORET

Ermet Rizaq Oriada Jaho
ME PROKUROR
Aleks Jaho

